



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

BULETINI

I REFERATEVE TË KANDIDATËVE TË PARAQITUR NË
KONKURSIN Nr. 01-167 TË DATËS 03.08.2020
PËR KONKURS PËR EMËRIMIN, RIEMËRIMIN
DHE AVANCIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT

1. Referat për zgjedhjen e një (1) Asistent (në përputhje me nenin 174 të Statutit) për lëndët nga lëmi i Agrobiznesit: Projekte në Agrobiznes, BE-ja dhe Politikat e Përbashkëta Bujqësore, Ekonomiks, Çmimet dhe Tregjet e Produkteve Bujqësore, Ekonomia Bujqësore, Menaxhimi i Fermave, Menaxhim Agrobiznesi, Logjistikë e Avancuar në Agrobiznes.

1. Msc. Nol Krasniqi

2. Referat për zgjedhjen e një (1) Asistent (në përputhje me nenin 174 të Statutit) për lëndët nga lëmi i Biologjisë: Biologjia e Shtazëve, Biologjia e Bimëve, Gjenetika e Pyjeve, Ekologji e Bimëve dhe Gjeobotanikë, Sistematikë dhe Botanikë e Pyjeve, Mikrobiologjia Ekologjike dhe Monitorimi i Mjedisit.

1. Msc. Liridon Buqaj



RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK

Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit

Një asistent (në përputhje me nenin 174 të Statutit) për lëndët nga lëmi i agrobiznesit: Projekte në Agrobiznes, BE-ja dhe Politikat e Përbashkëta Bujqësore, Ekonomiks, Çmimet dhe Tregjet e Produkteve Bujqësore, Ekonomia Bujqësore, Menaxhimi i Fermave, Menaxhim Agrobiznesi, Logjistikë e Avancuar në Agrobiznes.

Kandidatët e paraqitur sipas kohës së aplikimit në Konkursin e datës 3.8.2020, nr. ref.: nr. 01-167

1. Msc. Noj Krasniqi

Komisioni recensues:

1. Kryetar Prof. ass. dr. Ekrem Gjokaj
2. Anëtar Prof. ass. dr. Kushtrim Braha
3. Anëtar Prof. ass. dr. Sadik Maloku

Raporti i recensionit:

Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit

Një asistent (në përputhje me nenin 174 të Statutit) për lëndët nga lëmi i agrobiznesit: Projekte në Agrobiznes, BE-ja dhe Politikat e Përbashkëta Bujqësore, Ekonomiks, Çmimet dhe Tregjet e Produkteve Bujqësore, Ekonomia Bujqësore, Menaxhimi i Fermave, Menaxhim Agrobiznesi, Logjistikë e Avancuar në Agrobiznes.

Të dhënat mbi kandidatin

Emri dhe mbiemri: **Nol Krasniqi**

Datëlindja dhe vendlindja: **13.04.1990, Prishtinë**

Gradat shkencore: **Master Shkencës në zhvillim rural dhe agrobiznes (vendimi i njohjes nga MASHT, nr. 6-3284, datë 04.10.2016)**

Universiteti: **Universiteti Szent Istvan, Godollo, Hungari**

Titujt akademikë: **Asistent i regullt në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren.**

Viti kur është fituar titulli aktual: **31.5.2017 vendimi me nr. protokoli 124/1**

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor

Kontributi shkencor i kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen publikimet më të rëndësishme duke u bazuar në CV e kandidatit)

Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe numri i përgjithshëm i punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore

Veprimtaria shkencore e kandidatit	Prej fillimit të karrierës	Gjatë 4 vjetëve të fundit
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si autor kryesor	-	-
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si koautor	-	-
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si autor kryesor dhe sipas nenit 3 të Udhëzimit Administrativ të MASHT UA 01-2018	2	2
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si koautor dhe sipas nenit 3 të Udhëzimit Administrativ të MASHT UA 01-2018	-	-
Numri i publikimeve në kongreset ndërkombëtare në formë të "proceedings" si autor kryesor ose si koautor	1	1
Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon)	-	-
Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar)	1	-

Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor	2	2
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja	-	-
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhën shqipe	-	-
Numri i librave ose monografive të botuara si koautor	-	-
Kontribute të tjera shkencore dhe artistike	-	2

Vërejtje lidhur me tabelën 1:

***Autor kryesor** konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve (ose që është i evidentuar si autor korrespondent). Autori kryesor konsiderohet ai, i cili ka dhënë idenë për punën shkencore dhe që e bart barrën kryesore për finalizimin e punimit shkencor.

****Koautorë** konsiderohen personat të cilët kanë kontribuar në punën eksperimentale ose në përgatitjen e punimit për publikim.

Punimet relevante të kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen në mënyrë të detajuar publikimet në bazë të të cilave bëhet zgjedhja/avancimi i kandidatit sidhe rëndësia e tyre dhe ndërlidhja me lëndët për të cilat zgjedhet/avancohet kandidati/ja)

Tabela 2. Punimet shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimeve në nivel ndërkombëtar

Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet	"Impact factor"	Nr. i citimeve	Indeksuar sipas, nenit 3 të UA 01-2018
Krasniqi, Nol., Nagy, Henrietta./ The Assessment of Three Measures (101, 103, 302) Under the National Plan of Agriculture and Rural Development of Kosovo/ <i>Economic and Regional Studies / Studia Ekonomiczne i Regionalne/ 2020/13(1)/70-86</i>			EBSCO, WordCat
Krasniqi, Nol./ The role and impact of Local Action Groups in Rural Development of Kosovo/ <i>Journal of Agribusiness and Rural Development / 2020/ 55(1)/ 17-28</i>			DOAJ, Index Copernicus
Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet	pa "Impact factor" *	Nr. i citimeve	Indeksuar sipas, nenit 3 të UA 01-2018
Krasniqi, Nol., Nagy, Henrietta./ The Assessment of Three Measures (101, 103, 302) Under the National Plan of Agriculture and Rural Development of Kosovo/ <i>Economic and Regional Studies / Studia Ekonomiczne i Regionalne/ 2020/13(1)/70-86</i>			EBSCO, WordCat
Krasniqi, Nol./ The role and impact of Local Action Groups in Rural Development of Kosovo/ <i>Journal of Agribusiness and Rural Development / 2020/ 55(1)/ 17-28</i>			DOAJ, Index Copernicus

Të dhënat për punimet tjera: Proceedings			
Krasniqi Nol.- Petrovic Nikolina (2017): Agricultural cooperatives in Western Balkan countries: Challenges and Opportunities UPIC- University of Prishtina International Student Conference 2017/pp.117. ISBN: 978-9951-00-199-1	/		
Krasniqi Nol. (2016): The Role of Local Action Groups in Rural Development of Kosovo. Future scientists for sustainable development, 3rd VUA Youth International Scientific Conference 2016/ pp.59-74. ISBN 978-963-269-451-1			
"Infrastructure, Logistic Potential, Access to Technology"/ "Local Action Groups in Kosovo" Agri- Environment, Sustainable Agriculture in the Light of European Environmental Targets 2015/ ISBN: 978-3-902849-25-0/p.76/p.86			
Të dhënat për punimet tjera: Kumtesat shkencore			
Autori në dosjen e aplikimit ka paraqitur artikuj dhe kumtesa në konferenca të ndryshme, si dhe pas hulumtimeve në internet të njëjtat ekzistojnë të publikuara në faqe të ndryshme interneti.			

Shënim: Në bazë të kërkimeve në listat e publikimeve të botuesve apo revistave të dyshimta rezultoi se asnjëra nga revistat ku ka botuar kandidati, Nol Krasniqi, nuk janë të përfshira në këto lista të dyshimta sipas nenit 3, paragrafi 5 i udhëzimit administrativ të MASHT-it 01-2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare.

2. Përvoja në mësimdhënie universitare

1. Në këtë pjesë të raportit shënohen gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit, si universitetet ku ka punuar ai, sidhe aktivitetet mësimore dhe profesionale;
2. Me rastin e zgjedhjes/rizgjedhjes së asistentëve në Fakultetin e Mjekësisë përparësi kanë kandidatët që vijnë/kanë specializimin nga lëmia përkatëse ku konkurrojnë.

2017–2020 (3 vite akademike)

Në bazë të rezymesë së kandidatit, rezulton se i njëjti është asistent i regullt në Fakultetin e Shencave të Jetës dhe Mjedisit sipas vendimit të datës 31.5.2017 me nr. protokoli 124/1. Kandidati Nol Kasniqi ka mbajtur për tre vite ushtrimet të cilat janë shpallur në konkurs (numër 01-167 të datës 03.08.2020) për lëndët e agrobiznesit në Fakultetin e Shencave të Jetës dhe Mjedisit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren. Për më tëper, ai ka mbajtur edhe

ushtrimet në Fakultetin Ekonomik, po të njëjtin Universitet, dëshmia kontrata për orët e mbajtura.

3. Përgjegjësitë për aktivitetet në shërbim të njësisë akademike dhe udhëheqja në hulumtim

(Në këtë pjesë të raportit shënohen pozitat dhe funksionet udhëheqëse, aktivitetet në lidhje me zhvillimin profesional si dhe projektet shkencore të realizuara nga kandidati)

Nga viti 2013 ka përvojë në projekte hulumtuse në vendet e BE-së, në këtë vit ka qënë pjesëmarrës në Higher Kos Training, Project: "Sustainable Agriculture in the Light of European targets" (Austria). Që nga viti 2014 është bashkëthemelues dhe kryetar i grupit punues të YPARD Kosova. Misioni i YPARD-it (Profesionistët e Rinj për Zhvillimin e Bujqësisë) është të shërbej si platformë kolektive globale duke i mundësuar profesionistëve të rinjë të zbatojnë potencialin e tyre të plotë si dhe të kontribuojnë drejt zhvillimit inovativ bujqësorë. Nga viti 2017 ka qënë konsulent për projektin e FADN-së (Rrjeti i kontabilitetit të të dhënave në Fermë), projekt nga konzorciumi francez me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Gjatë periudhës 12.2018 – 12.2019 ka qënë i angazhuar si ekspert i menaxhimit dhe analizave të dhënave për projektin e Organizatës Botërore Bujqësisë dhe Ushqimit (FAO) për krijimin e databazës për analizimin e të dhënave statistikore për hulumtime në sektorin e bujqësisë dhe agrobiznesit në Kosovë. Po ashtu, gjatë vitit 2018 ka qënë i angazhuar si specialist për ofrimin e trajnimit për certifikimin e kandidatëve për shërbime këshillimore në bujqësi dhe zhvillim rural dhe përmirësimin e efektivitetit të stafit këshillues për konsurciumin italian P.A.N.G.E.A. Società Cooperativa Consortile. Që nga viti 2018, Nol Krasniqi kryen detyrën e shefit për mësim me vendim nga Këshilli i Fakultetit në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, ku është përgjegjës për procesin mësimor në dy programet, Agrobiznes si dhe Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit, detyrat i ka përmbushur me përgjegjesi të plotë ku ka kontribuar në shumë raporte dhe komisione në kuadër të fakultetit si dhe Universitetit në tërësi, poashtu një kontribut të veçantë ka dhënë në promovimin e fakultetit si dhe hartimin e raporteve të vetëvlerësimit për fakultetin. Po ashtu është pjesë e projektit ndërkombëtar "Krijimi i teorisë në qendrat praktike për inovacion dhe punësim CTPCIE (Numri i Projektit: 586347-EPP-1-2017-1-XK-EPPKA2-CBHE-JP 2017-3485 / 001-001)", ku në kuadër të këtij projekti ka përfaqësuar Universitetin e Prizrenit në Irlandën e Veriut si dhe në Austri.

Kandidati, Nol Krasniqi, ka një eksperiencë mjaft të gjatë në lëmin e agrobiznesit e vërtetuar me pjesëmarrje e tij në projekte, trajnime, grupe punuese etj. Rrjedhimisht, ai ka qëndruar për këto qëllime në vende të ndryshme, si: në Hungari, Francë, Bullgari, Poloni, Austri, Itali etj. Në dosjen e tij ka deponuar edhe disa certifikata të trajnimeve dhe pjesëmarrjeve të ndryshme profesionale në lëmin e ekonomisë së bujqësisë, agrobiznesit dhe të njohjes së gjuhës angleze.

4. Mobiliteti i kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati, si dhe institucionet e tjera në të cilat ka qëndruar për qëllime pedagogjike shkencore)

Kandidati, Nol Krasniqi, ka përfunduar studimet Bachelor në drejtimin Agroekonomi, Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin "Hasan Prishtina" Prishtinë, me notë mesatare 8.07.

Studimet pasuniversitare i ka përfunduar në Universitetin "Szent Istvan" Hungari, ku me përfundimin e tyre mori gradën MSC. në Zhvillim Rural dhe Agrobiznes (vendimi i njohjes nga MASHT, nr. 06-3282, datë 04.10.2016). Studimet i ka përfunduar me mesatare të lartë 4.73 (sistemi i notimit në Hungari është nga 1 deri 5).

Kandidati është në përfundim të studimeve të doktoratës në "University of National and World Economy" Sofie, Bullgari, në programin e (Agribusiness, Eco-Economics), ku i ka mbetur vetëm mbrojtja finale e tezës së doktoratës. Njëkohësisht kandidati është në vitin e dytë të studimeve të doktoratës në Universitetin Bourgundy në Francë, si bursist i qeverisë Franceze.

5. Titulli i cili propozohet (për të gjithë kandidatët)

(Anëtarët e Komisionit recensues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim të detajuar lidhur me titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë arsyet e bazuara në Statut dhe në Konkurs dhe përse kandidati i përzgjedhur e meriton më shumë se të tjeret që të propozohet).




Kandidati, **Nol Krasniqi**, i **plotëson** kriteret e zgjedhjes për thirrjen akademike **Asistent**, duke u mbështetur në dëshmitë si në vijim:


- Posedon gradën *Master Shkence në Zhvillim Rural dhe Agrobiznes*;
- Ka të regjistruar studimet e doktoratës. *(në përputhje me nenin 174 të Statutit, kandidatët të cilët aplikojnë për rizgjedhje asistent duhet të jenë të regjistruar në studimet e doktoratës)*
- Ka thirrjen Msc. Ass në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren (vendimi 01-124 i datës 31.05.2017);

- E plotëson me përpikëri profilin akademik për lëndët ku ka konkurruar;
- Ka publikuar 2 punime shkencore si autor kryesor në revista shkencore ndërkombëtare (të indeksuara në EBSCO, DOAJ, Worldcat sipas nenit 3, paragrafi 1 i UA të MASHT-it 01-2018);
- Ka marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare si autor dhe koautor;
- Ka marrë pjesë aktivisht në trajnime, specializime dhe projekte profesionale-shkencore në vendet e ndryshme të BE-së;
- Ka përvojë pune në fushën e ekonomisë së bujqësisë dhe agrobiznesit;
- Komunikon, shkruan dhe lexon rrjedhëshëm në gjuhën angleze si dhe flet gjuhën franceze dhe hungareze.

Duke u bazuar në këto që cekëm më lart dhe në bazë të kushteve të konkursit dhe nenit 174 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, kandidati, Msc. Nol Krasniqi PhD kandidat **i plotëson në tërësi të gjitha kushtet për t'u zgjedhur në thirrjen Asistent.** Kështu që komisioni me kënaqësi të veçantë i propozon njëzëri Senatit të UPZ-së, që Msc. ass. Nol Krasniqi PhD kandidat ta zgjedhë Asistent për lëndët nga lëmi i agrobiznesit: *Projekte në Agrobiznes, BE-ja dhe Politikat e Përbashkëta Bujqësore, Ekonomiks, Çmimet dhe Tregjet e Produkteve Bujqësore, Ekonomia Bujqësore, Menaxhimi i Fermave, Menaxhim Agrobiznesi, Logjistikë e Avancuar në Agrobiznes.*

Komisioni recensues:

- | | | |
|------------|-------------------------------|--|
| 1. Kryetar | Prof. ass. dr. Ekrem Gjokaj |  |
| 2. Anëtar | Prof. ass. dr. Kushtrim Braha |  |
| 3. Anëtar | Prof. ass. dr. Sadik Maloku |  |



RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK

Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit

Një asistent (në përputhje me nenin 174 të Statutit) për lëndët nga lëmi i biologjisë: Biologjia e Shtazëve, Biologjia e Bimëve, Gjenetika e Pyjeve, Ekologji e Bimëve dhe Gjeobotanikë, Sistematikë dhe Botanikë e Pyjeve, Mikrobiologjia Ekologjike dhe Monitorimi i Mjedisit.

* Kandidatët e paraqitur sipas kohës së aplikimit në Konkursin e datës 3.8.2020, nr. ref.: nr. 01-167

1. Msc. Liridon Buqaj

Komisioni recensues:

1. Kryetar Prof. ass. dr. Mirvjena Kellezi
2. Anëtar Prof. dr. Idriz Vehapi
3. Anëtar Prof. ass. dr. Bekim Gashi

** Sipas dokumentacionit të ofruar nga ana e fakultetit ka kandiduar vetëm një kandidat!*

Raporti i recensionit:

Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit

Një asistent (në përputhje me nenin 174 të Statutit) për lëndët nga lëmi i biologjisë: *Biologjia e Shtazëve, Biologjia e Bimëve, Gjenetika e Pyjeve, Ekologji e Bimëve dhe Gjeobotanikë, Sistematikë dhe Botanikë e Pyjeve, Mikrobiologjia Ekologjike dhe Monitorimi i Mjedisit.*

Të dhënat mbi kandidatin

Emri dhe mbiemri: **Liridon Buqaj**

Datëlindja dhe vendlindja: **31.10.1989, Prizren**

Gradat shkencore: **Master i Shkencave të Biologjisë**

Universiteti: **Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Kosovë**

Titujt akademikë: **Asistent i rregullt në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren.**

Viti kur është fituar titulli aktual: **31.5.2017 vendimi me nr. protokoli 01-126**

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor

Kontributi shkencor i kandidatis

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen publikimet më të rëndësishme duke u bazuar në CV e kandidatis)

Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe numri i përgjithshëm i punimeve shkencore të kandidatis, të cilat tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore

Veprimtaria shkencore e kandidatis	Prej fillimit të karrierës	Gjatë 4 vjetëve të fundit
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si autor kryesor	-	-
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si koautor	-	-
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si autor kryesor dhe sipas nenit 3 të Udhëzimit Administrativ të MASHT UA 01-2018	-	1
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si koautor dhe sipas nenit 3 të Udhëzimit Administrativ të MASHT UA 01-2018	-	-
Numri i publikimeve në kongreset ndërkombëtare në formë të "proceedings" si autor kryesor ose si koautor	-	-
Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon)	-	-
Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar)	-	-
Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor	-	-

Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja	-	-
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhën shqipe	-	-
Numri i librave ose monografive të botuara si koautor	-	-
Kontribute të tjera shkencore dhe artistike	-	-

Vërejtje lidhur me tabelën 1:

***Autor kryesor** konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve (ose që është i evidentuar si autor korrespondent). Autori kryesor konsiderohet ai, i cili ka dhënë idenë për punën shkencore dhe që e bart barrën kryesore për finalizimin e punimit shkencor.

****Koautorë** konsiderohen personat të cilët kanë kontribuar në punën eksperimentale ose në përgatitjen e punimit për publikim.

Punimet relevante të kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen në mënyrë të detajuar publikimet në bazë të të cilave bëhet zgjedhja/avancimi i kandidatit sidhe rëndësia e tyre dhe ndërlidhja me lëndët për të cilat zgjedhet/avancohet kandidati/ja)

Tabela 2. Punimet shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimeve në nivel ndërkombëtar

Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet	"Impact factor"	Nr. i citimeve	Indeksuar sipas, nenit 3 të UA 01-2018
1. Fatmir FAIKU, Liridon BUQAJ, Arben HAZIRI (2019), Phytochemicals and antioxidant study of <i>Teucrium chamedrys</i> (L.) plant. Agriculture & Forestry, Vol. 65 Issue 1: 137-145, 2019, Podgorica.			DOAJ, WordCat
Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet	pa "Impact factor" "	Nr. i citimeve	Indeksuar sipas, nenit 3 të UA 01-2018
Të dhënat për punimet tjera: Proceedings			
Të dhënat për punimet tjera: Kumtesat shkencore			

Shënim: Në bazë të kërkimeve në listat e publikimeve të botuesve apo revistave të dyshimta rezultoi se revista ku ka botuar kandidati, Liridon Buqaj nuk është e përfshirë në këto lista të dyshimta sipas nenit 3, paragrafi 5 i udhëzimit administrativ të MASHT-it 01-2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare.

2. Përvoja në mësimdhënie universitare

- 1. Në këtë pjesë të raportit shënohen gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit, si universitetet ku ka punuar ai, sidhe aktivitetet mësimore dhe profesionale;*
- 2. Me rastin e zgjedhjes/rizgjedhjes së asistentëve në Fakultetin e Mjekësisë përparësi kanë kandidatët që vijnë/kanë specializimin nga lëmia përkatëse ku konkurrojnë.*

2016–2020 (4 vite akademike)

Në bazë të dokumentacionit të kandidatit, rezulton se i njëjti ka qenë asistent i angazhuar në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" sipas vendimit të datës 24.12.2016 me nr. protokoli 3/699.

Sipas vendimit të datës 31.05.2017 dhe me numër protokoli 01-126, Msc. Liridon Buqaj zgjedhet Asistent në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, për grup lëndesh nga Biologjia. Prandaj, Ass. Liridon Buqaj ka përvojë tre vjeçare në realizimin e mësimin paraktik (ushtrimeve) për lëndët e shpallur në konkurs në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.

3. Përgjegjësitë për aktivitetet në shërbim të njësisë akademike dhe udhëheqja në hulumtim

(Në këtë pjesë të raportit shënohen pozitat dhe funksionet udhëheqëse, aktivitetet në lidhje me zhvillimin profesional si dhe projektet shkencore të realizuara nga kandidati)

Nga viti 2018, Liridon Buqaj është zgjedhur anëtar i senatit të Universitetit "Ukshin Hoti" nga radhët e stafit akademik të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit. Aktivisht ka marrë pjesë në komisione për qështje studentore por edhe grupe punuese dhe aktivitete tjera që kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së institucionit.

4. Mobiliteti i kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati, si dhe institucionet e tjera në të cilat ka qëndruar për qëllime pedagogjike shkencore)

Kandidati, Liridon Buqaj ka përfunduar studimet themelore në vitin 2012 në departamentin e Biologjisë në kuadër të FSHMN-së Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në programin studimor Bachelor i Biologjisë – Arsimor, me notë mestare 9.38 dhe me 240 ECTS (studime 4 vjeçare).

Studimet Master i ka përfunduar në vitin 2015 në po të njëjtin departament respektivisht universitet në programin studimor Master i Shkencave të Biologjisë (drejtimi arsimor) me notë mestare 9.63.

Në vitin akademik 2018/19 ka regjistruar studimet e doktoratës në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore në Universitetin "Hasan Prishtina", në programin Biologji e organizmave dhe Ekologji.

5. Titulli i cili propozohet (për të gjithë kandidatët

(Anëtarët e Komisionit recensues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim të detajuar lidhur me titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë arsyet e bazuara në Statut dhe në Konkurs dhe përse kandidati i përzgjedhur e meriton më shumë se të tjeret që të propozohet).

Kandidati, **Liridon Buqaj, i plotëson** kushtet dhe kriteret e zgjedhjes për thirrjen akademike Asistent, sepse:


- e ka gradën Master i Shkencave të Biologjisë;
- ka të regjistruar studimet e doktoratës;
- ka thirrjen Asistent në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren;
- e plotëson me përpikëri profilin akademik për lëndët ku ka konkuruar;
- ka publikuar 1 punim shkencor si koautor;
- ka notën mesatare relativisht të lartë në studimet bazike (9.38) dhe ato master (9.63).

Prandaj, duke u bazuar në këto që cekëm më lart dhe në bazë të kushteve të konkursit dhe nenit 174 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, kandidati, Ass. Msc. Liridon Buqaj PhD kandidat **i plotëson në tërësi të gjitha kushtet dhe kriteret për t'u zgjedhur-rizgjedhur në thirrjen Asistent.** Kështu që, komisioni me kënaqësi të veçantë i propozon njëzëri Senatit të UPZ-së, që Ass. Msc. Liridon Buqaj ta zgjedh Asistent për lëndët nga lëmi i biologjise: *Biologjia e Shtazëve, Biologjia e Bimëve, Gjenetika e Pyjeve, Ekologji e*

*Bimëve dhe Gjeobotanikë, Sistematikë dhe Botanikë e Pyjeve, Mikrobiologjia Ekologjike
dhe Monitorimi i Mjedisit*

Komisioni recensues:

1. Kryetar Prof. ass. dr. Mirvjena Kellezi
2. Anëtar Prof. dr. Idriz Vehapi
3. Anëtar Prof. ass. dr. Bekim Gashi



Three horizontal lines with handwritten signatures in blue ink. The first signature is for Prof. ass. dr. Mirvjena Kellezi, the second for Prof. dr. Idriz Vehapi, and the third for Prof. ass. dr. Bekim Gashi.